



LAND

OBERÖSTERREICH

LANDI  
AUSTRIA E EPËRME



SHQIP

# INTEGRIMI

ORGANIZIMI I DETYRUESHËM –  
FUQIZIMI I KOHEZIONIT

KONCEPTI I INTEGRIMIT TË LANDIT TË AUSTRISË SË EPËRME

**Poseduesi i medias dhe botuesi**

Landi Austria e Epërme

Zyra e Qeverisë së Landit të  
Austriës së Epërme  
Drejtoria e Presidiumit  
Departamenti i Shtypit  
Landhausplatz 1  
4021 Linz  
Tel.: 0732/7720-11400  
E-Mail: pr.post@ooe.gv.at

**Redaksia dhe shoqërimi shkencor**

Univ.-Prof. Dr. Katharina Pabel, Dipl. Soz. Kenan D. Güngör

**Ilustrimi:** Max Krasnov – stock.adobe.com

**Grafika:** Johannes Ortner/Departamenti i shtypit/Qendra e DTP [2018779]

Botimi i 1-rë, Qershor 2018

[www.land-oberoesterreich.gv.at](http://www.land-oberoesterreich.gv.at)

**Informacione mbi mbrojtjen e të dhënave personale gjeni në**

<https://www.land-oberoesterreich.gv.at/datenschutz>

## 7 1. Objektivat e politikës integruese

## 8 2. Parimet e politikës integruese

- 8 Kushtet për integrimin e suksesshëm
- 8 Integrimi si proces afatgjatë i përgjithshëm social
- 8 Integrimi si proces reciprok me kërkesa të ndryshme
- 9 Pritshmëritë kundrejt emigrantëve
- 9 Pritshmëritë kundrejt shoqërisë pritëse
- 9 Çelja e shanseve dhe mundësimi i pjesëmarrjes
- 10 Të drejtat themelore dhe të njeriut si bazë e përbashkët
- 10 Ndreqja e mjediseve problematike
- 11 Vlera qendrore themelore

## 12 3. Qëndrimet e një politike integruese aktivizuese dhe detyruese

- 12 Aktivizuese & aftësuese
- 12 Detyruese: nxitëse & kërkuese
- 13 Bazuar në nevoja, bazuar në dije & efektive
- 13 E orientuar në të ardhmen & e qëndrueshme
- 14 Me orientim të kryqëzuar & lidhës

## 14 4. Sektorët qendror të politikës integruese

- 14 Gjuha dhe arsimit si kualifikime kyç
- 15 Ekonomia dhe tregu i punës – Forcimi i pjesëmarrjes
- 17 Integrimi dhe bashkëjetesa në vend
- 17 Vlerat dhe traditat të cilat ja vlen të transmetohen
- 18 Respekt në sjelljen me njëri-tjetrin



**Vetëm kohezioni i brendshëm i fortë i shoqërisë në një vend** ndikon që të arrihen gjëra të mëdha dhe të implementohen vizione. Vetëm një shoqëri, e cila punon në objektiva të përbashkëta mund të krijojë atë siguri për të cilën ne njerëzit kemi nevojë.

Prandaj, integrimi i njerëzve nga qarqet e tjera kulturorë, të cilët kërkojnë një atdhe të ri në Austrinë e Epërme, ka një rëndësi vendimtare. Bashkëjetesa duhet të jetë e sigurt, e ndershme dhe sociale dhe për këtë gjë duhet që mundësitë e integritit të jenë organizuar të orientuar në objektiva dhe në mënyrë të pagabueshme.

Me këtë koncept integrimi ne duam të krijojmë orientim dhe të ndërtojmë ura; por bëhet fjalë edhe për faktin që të transmetohet në mënyrë të saktë dhe të qartë, që ne të përfytyrojmë jetesën e përbashkët në atdheun tonë. Këtu përfshihet njohja e qartë e gjuhës së përbashkët gjermanisht si dhe kornizës tonë të vlerave. Unë dëshiroj një jetesë të mirë të përbashkët në Austrinë e Epërme, jo pranë njëri-tjetrit dhe aq më pak kundër njëri-tjetrit.

Përfaqësueset dhe përfaqësuesit e të gjitha partive politike të kuvendit të landit e Austrinë e Epërme kanë zhvilluar më tej konceptin e integritit të landit të Austrisë së Epërme të krijuar tashmë në vitin 2008, bashkë me eksperte dhe ekspertë nën koordinimin e akademisë së të ardhmes dhe e kanë përshtatur me kushtet e sotshme shoqërore.

Rezultati është një busull për një bashkëjetesë të suksesshme në Austrinë e Epërme – Shprehje e qëndrimit tonë themelor mbi integritin dhe bashkëjetesën shoqërore.

Unë i falënderoj të gjithë përfshirët në këtë projekt për këtë punë shumë të rëndësishme dhe i uroj neve të gjithëve një bashkëjetesë të mirë dhe një kohezion të fortë në Austrinë e Epërme.

Guvernatori  
**Mag. Thomas Stelzer**



**Sfidat shoqërore në sektorin e integritit** kanë ndryshuar shumë në vitet e fundit për shkak të rritjes së emigracionit të shtetasve nga vende të treta që i përkasin një kulture të huaj. Prandaj riorientimi i konceptit të integritit të Austrisë së Epërme kërkohej me shumë ngut. Në disa sektorë, dështimet kanë shkaktuar mjedise larg integritit deri në armiqësore kundrejt integritit, të cilat duhen shpërndarë me ngut. Kjo nuk ka të bëjë vetëm me emigrantët e rinj, por edhe me njerëz të cilët jetojnë tashmë prej shumë vitesh te ne, me dhe pa shtetësi austriake, si dhe gjeneratat e tyre të dyta dhe të treta të pasardhësve. Natyrisht që ka pasur edhe përvoja pozitive me integritime që kanë funksionuar mirë. Pikërisht këto kanë treguar që gatishmëria personale, për t'ju përshtatur shoqërisë së re është e domosdoshme për një integritim funksional. Por nga sa çfarë është parë, nuk mjafton vetëm krijimi i ngacmimeve për këtë gatishmëri. Në rast refuzimi dhe mosndjekje të masave integruese duhet të ketë edhe konsekuenca të ndjeshme. Vetëm në rastin kur emigrantët ta kenë shlyer borxhin e tyre si dhe të kenë pranuar ligjet dhe vlerat e kulturës perëndimore austriake, integrimi mund të funksionojë. Shoqëritë paralele të cilat vendosin për shembull urdhëresat fetare mbi ligjet tona legjitime demokratike, duhen kundërshtuar në mënyrë konsekuente.

Është kënaqësi për mua, që tani në konceptin e ri është futur një ndryshim perspektive që ka lidhje me realitetin. Koncepti i integritit 2018 i Austrisë së Epërme përcakton një rrugë të re dhjetë vjet pas krijimit të konceptit të parë, për të menaxhuar sfidat me të cilat ne përballemi sot.

Për garantimin e lirisë sociale dhe të së ardhmes së vendit tonë, integrimi më i mirë i mundshëm i të huajve të cilët lejohen të jetojnë gjatë gjithë kohës në vendin tonë është i pashmangshëm.

Zëvendës Guvernatori  
**Dr. Manfred Haimbuchner**

© Andreas Balon



Po, integrimi është një sfidë, dhe është një proces, i cili nuk mund të përfundojë nga sot për nesër por që zgjat për shumë vite. Si për njerëzit të cilët ishin të detyruar të largoheshin për shkak të luftës, shtypjes dhe përndjekjes dhe të cilëve ju akordua mbrojtje në Austri, ashtu edhe për ne Austriaket dhe Austriakët e lindur në Austrinë e Epërme, që duhet të mësojmë se si të sillemi me fqinjat dhe fqinjët e rinj, shoqet dhe shokët e rinj të klasës, koleget dhe kolegët e rinj, një gjë e tillë është e domosdoshme. Për të dyja palët është një sfidë, por për të dyja palët mund të jetë edhe një shans – dhe një gjë është e qartë: Ne dëshirojmë të jetojmë mirë së bashku.

Rezervat hiqen më mirë duke e njohur njëri-tjetrin dhe duke komunikuar me njëri-tjetrin. Për këtë gjë shumë komuna të Austrisë së Epërme ofrojnë shpesh në kuadrin e eventeve të përcaktuara si dhe të shumë iniciativave vullnetare të integrimi mundësi të mrekullueshme, të cilat unë ju këshilloj ti frekuentoni.

Logjika dhe qëllimi i këtij koncepti të integritimit është që të paraqesim që landi federal i Austrisë së Epërme posedon vullnetin që të mbështesë bashkëjetesën e kulturave të ndryshme dhe që mbështet rregullat të cilat në vendin tonë vlejné për të gjithë njerëzit – plotësisht të pavarur nga vendi i lindjes dhe vendi i origjinës. Dhe prandaj është e rëndësishme që e gjithë qeveria e landit, pavarësisht orientimit të tyre partiak dhe politik, ra dakord mbi këto parime, mbi bazën e qartë të kuptimit të përbashkët, të mundësisë për të folur me njëri-tjetrin, pasi „duke biseduar njerëzit bashkohen“.

Këshilltari i landit  
Rudolf Anschöber

© Land 06



Para më shumë se 50 vjetësh, Austria ka marrë në mënyrë aktive punëtorë në Ish-Jugosllavi dhe në Turqi. Burrat u transportuan me tren për në Austri dhe u shpërndanë këtu te ato kompani, të cilat kishin nevoja imediate për personel.

Integrimi? Nuk dëshirohej. Nuk kishte kurse gjermanishte. Punëtorët strehoheshin në baraka dhe në vendstrehime masive.

Sot ne dimë që: Nëse njerëzit vijnë te ne, atëherë ne duhet të përpiqemi që ti integrojmë ato në bashkësi. Pasi vetëm kështu mund të funksionojë jetesa e përbashkët. Ndërkohë që integrimi kërkon nga të dyja palët. Integrimi nuk të jep vetëm të drejta, por kërkon edhe përmbushjen e detyrimeve.

Nevoja për forcë punëtoresh nga vendet e huaja sot është po aq e lartë sa në vitet 1960. Ne kemi nevojë në mënyrë shumë imediate për punonjës të specializuar dhe ndihmës. Në industri, në gastronomie, në profesionet e shëndetësisë dhe të përkujdesjes.

Nëse ne jemi të zgjuar, ne duhet ta kuptojmë ardhjen e njerëzve nga vende të tjera – si refugjatë lufte ashtu edhe punonjës të specializuar – si shans, si përforsim për shoqërinë tonë. Nëse ne jemi të zgjuar, ne ju transmetojmë atyre vlerat dhe traditat tona dhe përpiqemi si që anasjelltas të mësojmë nga njerëzit e ardhur. Nëse ne jemi të zgjuar, ne duhet të bëjmë gjithçka që gratë dhe burrat e ardhur, fëmijët dhe të rinjtë të mund të lëshojnë rrënjë te ne.

DUKE qenë se ne jemi të zgjuar, ne në Austrinë e Epërme përballemi hapur dhe të paanshëm me këtë temë të madhe. Ky koncept integrimi është baza për këtë gjë.

Këshilltare e landit  
Birgit Gerstorfer, MBA





**Koncepti i integritit i zhvilluar në vitin 2008 „Përfshirja në vend të klasifikimit“** formoi bazën për organizimin e programuar të politikës së integritit për landin e Austrisë e Epërme. Kjo kishte si qëllim, të implementojë punën me orientim të kryqëzuar në mbarë vendin si dhe atë rajonale dhe të mundësojë një bashkëjetesë të mirë. Që prej kësaj periudhe kohore puna e integritit është zgjeruar dhe profesionalizuar shumë. Vlerësimi i punës së deritanishme të integritit i dëshmoi landit gjithsej rezultate të mira.

Por përveç sukseseve dalin në pah edhe sfida dhe sektorë problematik, përballja me të cilët nuk ka shkuar siç duhet dhe duhet të përmirësohet me patjetër. Kjo vlen p.sh. për një pjesë të grupeve të emigrantëve dhe emigrantëve të rinj. Këtu përfshihet edhe dinamika dhe impakti o krizave dhe tensioneve globale, të cilat shfaqen përplasen në vend the ngarkojnë bashkëjetesën.

Çështje të tilla dhe të tjera e bënë të domosdoshme një rivlerësim dhe një theksim të politikës integruese. Kështu vlen që politika integruese të organizohet në të gjitha drejtimet në mënyrë më aktive dhe më detyruese. Kjo kërkon edhe që vlerat, qëndrimet dhe kërkesat për një bashkëjetesë të arritur të jenë arsytuar mirë dhe zonat problematike të mundë të përcaktohen më qartë.

Koncepti i ri bazohet në këtë frymë. Të gjitha partitë e përfaqësuara në kuvendin e landit përveç akseseve të tyre politiko-partiake, bazuar në arsyetimin dhe perceptimin e shëndoshë, kanë kërkuar të përbashkëta që shkojnë përtej partive. Pa këtë qëndrim kritik dhe bashkëpunues të të gjithë pjesëmarrësve ky koncept nuk do të ishte i mundur, prandaj unë ju shpreh juve respektin tim të veçantë.

Shoqërues shkencor  
Dipl. Soz. Kenan Dogan Güngör



**Organizimi i të ardhmes së të gjithë njerëzve që jetojnë në Austrinë e Epërme,** dhe bashkëjetesa e suksesshme pavarësisht nga prejardhja dhe shtetësia bazohen mbi kohezionin e shoqërisë. Koncepti i integritit i landit të Austrisë së Epërme ka si qëllim, të forcojë këtë kohezion. Bazuar në këtë logjikë ai formulon objektivat, parimet dhe qëndrimet e politikës së integritit të landit dhe e vendos fokusin e tij te të gjithë grupet e popullsisë – vendas dhe emigrantë.

Pritshmëritë kundrejt shoqërisë pritëse tregohen po ashtu si edhe pritshmëritë kundrejt emigrantëve, për të mundësuar pjesëmarrjen e të gjithëve në jetën ekonomike, sociale, kulturore dhe shoqërore në Austrinë e Epërme.

Koncepti i integritit thekson të drejtat themelore dhe të njeriut si bazë e përbashkët për një shoqëri të hapur dhe tregon vlerat qendrore themelore për një bashkëjetesë të suksesshme në larmi. Procesi i gjerë i diskutimit për zhvillimin e konceptit tregon gatishmërinë dhe angazhimin që ta trajtojmë integritimin së bashku si detyrë e të ardhmes.

Shoqëruese shkencore  
Univ.-Prof.<sup>in</sup> Dr.<sup>in</sup> Katharina Pabel

# ORGANIZIMI I DETYRUESHËM I INTEGRIMIT — FORCIMI I KOHEZIONIT

## KONCEPTI I INTEGRIMIT TË LANDIT AUSTRISË SË EPËRME

### 1. Objektivat e politikës së integrimit

**K**oncepti i integrimit i landit të Austrisë së Epërme ka titullin „Organizimi i detyrueshëm i integrimit – Forcimi i kohezionit“. Në këtë mënyrë shprehet objektivi dhe detyra e politikës së integrimit: Është detyra dhe përgjegjësia juaj të mundësoni një bashkëjetesë të suksesshme dhe paqësore të të gjithë njerëzve në Austrisë së Epërme, pavarësisht nga prejardhja dhe shtetësia e tyre. Këtë përgjegjësi ne e marrim përsipër.

Koncepti i integrimit i landit të Austrisë së Epërme krijohet në një periudhë kohore, që bë njërën anë karakterizohet ende nga sfidat, të cilat i kanë sjelle me vete numri i madh i refugjatëve dhe emigrantëve të tjerë sidomos në vitet 2015 dhe 2016. Pikërisht në vitet e kaluara, për këtë grup njerëzish të larguar janë ndërmarrë përpjekje të mëdha politiko-integruese. Nga ana tjetër, njerëzit nga shtetet e Bashkimit Evropian dhe nga vendet e shteteve të treta formojmë ashtu si më parë grupet më të rëndësishme të emigrantëve. Por politika integruese e institucionalizuar nuk i ka mbërritur ende tek ato. Por edhe integrimi i tyre ka rëndësi shumë të madhe për bashkëjetesën në Austrinë e Epërme dhe duhet të jetë po ashtu si integrimi i emigrantëve të rinj në fokusin e këtij koncepti. Koncepti i drejtohet gjithashtu edhe popullsisë vendase. Ai ka reaguar hapur dhe me shumë impenjim individual, por edhe me kujdes dhe skeptikë kundrejt zhvillimeve të ndryshme të emigracionet në vitet dhe dekadat e fundit. Objektivi i bashkëjetesës së suksesshme së të gjithë njerëzve në Austrinë e Epërme duhet të ketë në fokus të gjitha grupet e popullsisë – vendas dhe emigrantë –.

Koncepti i integrimit i landit Austrisë së Epërme koncepton bazat, konceptet dhe qëndrimet për politikën integruese të dhjetë viteve të ardhshme. Ajo bazohet në konceptin ekzistues të integrimit „Përfshirja në vend të klasifikimit – Të jetosh integrimin në Austrinë e Epërme “ e vitit 2008, reagon mbi kushtet e ndryshuara dhe zhvillon një perspektivë për të ardhmen. Koncepti i ri i integrimit përmban në mënyrë kompakte modelet strategjike për politikën e ardhshme integruese. Mbi këtë bazë zhvillohen masa konkrete dhe vendosen në dispozicion resurset përkatëse. Në këtë mënyrë krijohet një kornizë e detyrueshme veprimesh për politikën e ardhshme të integrimit dhe punën e ardhshme të integrimit duke përfshirë institucionet nxitëse në landin e Austrisë së Epërme.

## 2. Parimet e politikës integruese

### Kushtet për integrimin e suksesshëm

Për një integrim të suksesshëm dhe në këtë mënyrë për kohezionin shoqëror kushtet e mëposhtme janë bazë e domosdoshme: mësimi i gjuhës gjermane si gjuhë e përbashkët, puna aktive drejt një aftësie ekonomike vetë financuese, pranimi i vlerave themelore si dhe respekti kundrejt kulturës së vendit dhe asaj të përditshme në Austrinë e Epërme është baza e bashkëjetesës. Në të njëjtën kohë nevojitet edhe çelja dhe gatishmëria përkatëse e shoqërisë pritëse. Përpjekje integruese të emigrantëve dhe organizimi i integritit nga ana e politikës duhen orientuar kundrejt kësaj baze.

### Integrimi si proces afatgjatë i përgjithshëm social

Integrimi është një materie e kryqëzuar dhe përfshin në shkallë të ndryshme pothuajse të gjithë sektorët shoqëror. Ajo duhet të trajtohet jo si një temë e veçantë e izoluar, por si pjesë e politikës së një shoqërie, në të cilën emigracioni dhe shumëllojshmëria i përkasin jetës së përditshme. Politika integruese është në këtë mënyrë pjesë e politikës arsimore, ekonomike dhe të tregut të punës, politikës sociale dhe të banimit si dhe të politikës së sigurisë në konceptin më të ngushtë dhe të mëtejshëm. Ajo zhvillohet në formë të bashkërenduar dhe të dakortësuar në nivelin e politikës dhe administrimit të landit, të qyteteve dhe të komunave. Integrimi nuk është një hap, i cili bëhet njëherë dhe më pas ka përfunduar. Integrimi është më shumë një proces afatgjatë i cili ka nevojë për kohë dhe që duhet shoqëruar gjatë gjithë kohës, në mënyrë të besueshme dhe me shumë durim. Prandaj politika integruese orientohet në mënyrë afatgjatë, planifikon nevojat dhe kërkesat përkatëse për të ardhmen dhe siguron vazhdueshmëri.

### Integrimi si proces reciprok me kërkesa të ndryshme

Koncepti i integritit të landit të Austrisë së Epërme i drejtohet të gjithë personave dhe institucioneve, të cilat kanë të bëjnë në kuptimin e ngushtë dhe të gjerë me çështjet e integritit. Marrës janë si organizatat dhe institucionet shtetërore ashtu edhe ato jo shtetërore si administratat autoritetet rajonale, shoqëritë si dhe personat dhe grupet vendore dhe të ardhur, të cilët angazhohen në punën integruese. Koncepti i integritit nuk i drejtohet vetëm atyre që kanë ardhur para pak kohësh në Austrinë e Epërme, por edhe personave të cilët për arsye të ndryshme kanë emigruar para shumë vitesh në Austrinë e Epërme dhe me fëmijët e tyre dhe pjesërisht tashmë me nipërit e tyre janë pjesë e popullsisë së Austrisë së Epërme.



## Pritshmëritë kundrejt emigrantëve

Duke marrë parasysh kushtin e reciprocitetit duhet thënë që procesi i vendosjes dhe në këtë mënyrë kërkesat e integrimit për emigrantët është shumë më i lartë se sa ai për shoqërinë pritëse. Mësimi i një gjuhe të re, orientimi dhe mbërritje në një shoqëri të re kërkojnë nga emigrantët një sforco tepër më të madhe. Emigrantët duhet të angazhohen bazuar në mundësitë e tyre nëpërmjet angazhimit personal për mbërritjen dhe zhvillimin e tyre në Austrinë e Epërme. Me anën e mësimi të gjuhës gjermane, punës për aftësinë vetë-mbajtëse dhe pranimin e vlerave ju jepni kontributin tuaj për një integrim të suksesshëm.

## Pritshmëritë kundrejt shoqërisë pritëse

Këto përpjekje dhe mundime duhen mbështetur në mënyrë aktive nga shoqëria pritëse. Politika integruese ka për detyrë që të nxisë integrimin dhe kohezionin shoqëror dhe të krijojë kushtet e domosdoshme për këtë gjë. Landi i Austrisë së Epërme e konsideron si përgjegjësi të veten që përveç masave të federatës të krijojë me anën e një politike aktive integrimi të krijojë kushte dhe mundësi të mira. Vullnetarët – qofshin individë, grupe, shoqata fetare ose shoqata –, të cilat marrin përsipër në forma të ndryshme detyra në sektorin e mësimi të gjuhës, të kërkimit të vendit të punës ose të kërkimit të banesës ose japin ndihmesë, luajnë një rol të rëndësishëm në procesin e integrimit.

## Çelja e shanseve dhe mundësimi i pjesëmarrjes

Shumë nga bashkë-qytetaret dhe bashkë-qytetarët e ardhur, të cilët jetojnë prej një kohe të gjatë në Austri, janë familjarizuar me sukses prej një kohe të gjatë dhe kanë zënë vendin e tyre si pjesë e natyrshme e shoqërisë. Ato me punën dhe ndikimin e tyre kanë dhënë kontribut për zhvillimin social dhe ekonomik të vendit. Në të njëjtën kohë ekzistojnë edhe grupe të pjesshme, të cilët integrimi dhe përfshirja nuk ka pasur suksesin e mjaftueshëm. Nëpërmjet një integrimi të mëvonshëm duhen riparuar deficitet e të kaluarës; në të njëjtën kohë me anën e një pune integruese aktive duhet garantuar përfshirja e emigrantëve të rinj.

Përfshirja duhet ti aftësojë të gjithë – pavarësisht nga prejardhja ose shtetësia –, të marrin pjesë në jetën ekonomike, sociale, kulturore dhe shoqërore të Austrisë së Epërme. Kushtet e nevojshme për këtë gjë duhen krijuar nga politika integruese si në nivelin institucional ashtu edhe në nivelin informal. Me rëndësi të madhe për procesin integrues janë mundësitë e pritjes në sistemet e rregulluara dhe institucionet ekzistuese. Kushtet fillestare janë të ndryshme: Emigrantët duhet

që në shumicën e kohës të mësojnë gjermanishten si gjuhë të përdorimit të përditshëm, disa nga të ardhurit nuk e posedojnë arsimin dhe kualifikimin e përshtatshëm për tregun austriak të punës. Këtu duhen vendosur hapa nxitëse të integritit për të mundësuar një pjesëmarrje të mundshme.

Por integrimi kërkon edhe angazhimin e individit në varësi të aftësive dhe mundësive. Ndërkohë që pritet gatishmëria për të mësuar gjuhën gjermane, gatishmëria për arsimim dhe trajnim dhe gatishmëria që të angazhoheni aktiv në tregun e punës dhe në shoqëri. Këto pritshmëri i drejtohen kryesisht të gjithë njerëzve të cilët jetojnë në Austrinë e Epërme. Pengesat strukturore, të cilat qëndrojnë kundër pjesëmarrjes – si p.sh. procese e padrejta dhe të stërgjatura të njohjes dhe njehsimit të diplomave –, duhen indetifikuar dhe eliminuar.

## **Të drejtat themelore dhe të njeriut si bazë e përbashkët**

Në Austrinë e Epërme jetojnë njerëz me prejardhje dhe shtetësi të ndryshme. Por njerëzit ndryshojnë bazuar edhe në kritere të tjera si: mosha, gjinia, bindja e tyre fetare dhe politike. Larmia është në Austrinë e Epërme ashtu si në të gjithë Austrinë një realitet shoqëror. Me anën e emigracionit larmia bëhet më e madhe në vendin tonë. Larmia kulturore e njerëzve të cilët jetojnë në Austrinë e Epërme trajtohet me respekt. Larmia nga njëra anë do të thotë pasurim, por ajo në sektorë të caktuar mund të sjellë me vete irritime, keqkuptime, kundërshtime dhe probleme.

Prandaj kohezioni i një shoqërie në të cilën jetojnë njerëz të ndryshëm ka nevojë për vlera dhe rregulla të përbashkëta. Ne në Austrinë e Epërme e konsiderojmë veten tonë si një shoqëri të hapur e cila është e angazhuar për vlerat e saj themelore. Të drejtat themelore dhe ato të njeriut që akordohen në Austri formojnë në të njëjtën mënyrë si shteti ligjor dhe demokracia vlerat themelore të cilat janë baza e komunitetit. Këto vlera duhet të njihen dhe të pranohen dhe të mbështeten nga të gjithë. Detyrimet ligjore që rrjedhin nga ato duhen njohur dhe respektuar pa asnjë rezervë. Për sa kohë të gjithë i pranojnë këto vlera themelore, është e mundur një bashkëjetesë në shumëllojshmëri.

## **Ndreqja e mjediseve problematike**

Toleranca dhe çiltërsia karakterizojnë bashkëjetesën në Austrinë e Epërme. Toleranca zero vlen kundrejt rrymave dhe ideologjive, të cilat nuk respektojnë rregullat detyruese në Austri dhe në Austrinë e Epërme dhe venë në dyshim vlerat tona themelore. Ne refuzojmë përhapjen e urrejtjes, ekstremizmit të provuar fetar ose politik, islamizmit, ideologjive armiqësore kundrejt demokracisë dhe qëndrimet përçmuese kundrejt grupeve. Landi i Austrisë së Epërme i kundërshton këto rryma, rrjete, dhe institucione me mjetet e shtetit

ligjor, pa mohuar vlerat dhe principet e veta të barazisë dhe lirisë. Mjediset dezintegruese dhe problematike, në të cilat aplikohen mënyra jetesa të cilat nuk janë në përputhje me vlerat dhe rregullat tona themelore duhen kundërshtuar. Për këtë gjë janë të domosdoshme masa sigurie politike, sociale dhe parandaluese, të cilat duhet veprjnë shpejt dhe pengojnë një rrëshqitje të mundshme ose të mëtejshme në mjediset problematike dezintegruese.

## Vlera qendrore themelore

Vlerat qendrore themelore për bashkëjetesën rezultojnë në Austri dhe në Austrinë e Epërme nga përcaktimet kushtetuese dhe ligjet e vendit tonë, të plotësuara nga karta e të drejtave themelore të Bashkimit Evropian, dhe nga kontrata ndërkombëtare, sidomos nga karta e OKB. Prezantimet që gjendet aty mbi rregullin shtetëror dhe shoqëror janë zhvilluar prej shekujsh, nganjëherë janë fituar edhe me luftë dhe shpesh janë edhe një pikë tërheqje për emigracionin në Austri.

- ❖ **Demokracia dhe shteti ligjor:** Ligjet dhe rregullat e përgjithshme që kanë lidhje me to krijohet pas diskutimeve dhe nëpërmjet votimin të mëvonshëm nga përfaqësueset dhe përfaqësuesit e popullit në parlamente bazuar në rregulloret përkatëse të procedurave. Shteti është i detyruar të zbatojë këto ligje që janë krijuar në formë demokratike, kjo gjë e karakterizon atë si një shtet i së drejtës. Të drejtat dhe detyrimet që gjenden në ligje vlejnë për të gjithë njerëzit, të cilët jetojnë në Austri; ato duhen pranuar dhe respektuar pa asnjë rezervë.
- ❖ **Ndarja e shtetit dhe fesë / Liria e besimit:** Shteti Austriak vepron i pavarur nga asnjë fe, vendimet e tij janë neutrale kundrejt feve. Çdo person në Austri gëzon të drejtën të posedojë besimin e tij dhe në kuadrin i ligjeve ta ushtrojë atë ose ta organizojë jetën e vet pa e deklaruar një gjë të tillë. Respektimi i ligjeve në fuqi nuk mund të relativizohet duke u bazuar në rregulloret fetare.
- ❖ **Integriteti fizik dhe moral:** Dhuna fizike, psikike dhe seksuale, sidomos kundrejt fëmijëve dhe grave është e ndaluar. Për mbrojtjen kundrejt shfrytëzimit (seksual) janë ndaluar p.sh. martesat e detyruara dhe poligamia.
- ❖ **E drejta për organizimin individual të jetës dhe për lirinë e mendimit:** Çdo njeri mund ta organizojë jetën e vet në përputhje me besimin e tij, traditat e tij, interesat e tij dhe seksualitetit të tij. Për sa kohë ushtrimi i këtyre të drejtave është në përputhje me ligjet austriake, ato nuk lejohen të kufizohen.

- ❖ **Barazia gjinore:** Gratë dhe burrat posedojnë të njëjtat të drejta; të dyja palët përcaktojnë vetë mbi të gjitha aspektet e jetës tyre. Gratë duhen pranuar dhe respektuar njëjloj.
- ❖ **Shanset e arsimit dhe shkollimi i detyruar:** Vajzat dhe djemtë posedojnë të drejtën e barabartë të frekuentojnë institucionet arsimore të çdo lloji. Ekziston detyrimi i frekuentimit të kopshteve, shkollës dhe arsimit për vajzat dhe djemtë.

### 3. Qëndrimet e një politike integruese aktivizuese dhe detyruese

L andi i Austrisë së Epërme qëndron për një politikë integruese aktivizuese dhe detyruese. Ajo karakterizohet nga qasjet dhe parimet e mëposhtme:

#### → Aktivizuese & aftësuese

Qëllimi i politikës integruese është, që të gjithë njerëzit të mund ta përcaktojnë dhe ta organizojnë vetë jetën e tyre. Për këtë gjë në fillimin e procesit të integritimit mund të jetë e dobishme që njerëzit e ardhur të mbështetet nëpërmjet mundësive të përkujdesjes dhe të shoqërimit gjatë procesit të familjarizimit në Austrinë e Epërme. Nga përkujdesja duhen vendosur më pas hapa të një shoqërimi aftësues të cilat mund të përmbajnë masa konkrete p.sh. të arsimit, trajnimit dhe kualifikimit dhe të cilat në këtë mënyrë çojnë në pavarësi. Në këtë kontekst është e rëndësishme që personat që duhen integruar të mos shihen vetëm si pasiv në kuadrin e marrëses dhe marrësit të një shërbimi, por që ato me anën e masave aktivizuese dhe politike integruese të bëhen të aftë që ta marrin në dorë vetë jetën e tyre dhe të marrin pjesë në shoqëri. Një politikë integruese aktive funksionon më mirë nëse të gjithë pjesëmarrëset dhe pjesëmarrësit angazhohen në mënyrë vullnetare për familjarizimin dhe zhvillimin e tyre në shoqëri.

#### → Detyruese: nxitëse & kërkuese

Detyrimi reciprok është pjesë e mbërritjes në shoqëri, shprehje e vlerësimit dhe besimit reciprok dhe formon në këtë mënyrë një bazë shumë të rëndësishme të procesit të integritimit. Politika integruese duhet organizuar në mënyrë të detyrueshme nga të dyja palët dhe duhet të ndjekë parimin e nxitjes dhe kërkimit. Një gjë e tillë kërkon që objektivat të cilat duhet të arrihen me masat integruese, që janë përcaktuar ndërmjet ofruesve dhe marrësve, janë përcaktuar në mënyrë detyruese dhe respektimi dhe veprimi i tyre duhet kontrolluar. Motivimi dhe përpjekja aktive duhen vlerësuar

dhe nxitur. Ndërkohë që gatishmëria e munguar ose refuzimi kanë pasoja dhe duhet që të sjellin si pasojë edhe sanksione. Koncepti është i detyrueshëm në kuptimin që politika integruese dhe puna integruese, proceset nxitëse ashtu si edhe bashkëpunimet duhet të orientohen në objektivat, parimet dhe qëndrimet e vendosura atje. Integrimi i suksesshëm hap pjesëmarrjen në jetën ekonomike, sociale dhe shoqërore në Austrinë e Epërme. Zhvillimi (i mëtejshëm) i direktivave nxitëse bazuar në këtë koncept krijon detyrime reciproke ndërmjet ofruesve dhe marrësve të nxitjes, si për individë ashtu edhe për shoqata.

### → Bazuar në nevoja, bazuar në dije & efektive

Absorbimi i mirë i mundësive mund të garantohet në atë mënyrë që ato të organizohen në varësi të nevojave dhe grupeve që synohen të arrihen dhe janë në këtë mënyrë të realizueshme dhe të aksesueshme. Landi i Austrisë së Epërme i beson mundësive nxitëse të diferencuara, të orientuara te nevojat dhe potenciali, gjë që ka si kusht njohurin e saktë e nevojës individuale për mbështetje. Në sensin e një përdorimi ekonomik të mjeteve, masat nxitëse duhen parashikuar të diferencuara në varësi të statusit të qëndrimit të emigrantit. Duke ditur që gjatë integrimit dhe bashkëjetesës së suksesshme kemi të bëjmë me procese dinamike komplekse dhe shumëdimensionale, duhet që puna integruese të strukturohet bazuar në dije dhe në prova. Mbi këtë bazë duhen zhvilluar mundësi efektive të cilat synojnë aftësimin individual.

Orientimi kundrejt nevojave dhe efektivitetit vlen për të gjitha mundësitë nxitëse të landit që lidhen me integrimin. Tek orientimi efektiv përfshihen domosdoshmëria vlerësimit të aktiviteteve dhe masave integruese politike. Matja e sukseseve të integrimit, vlerësimi i masave integruese dhe monitorimi i procesit integruar kanë nevojë për një një ri-zhvillim dhe zhvillim të mëtejshëm përkatës. Në sensin e një përdorimi të qëndrueshëm të resurseve i duhet kushtuar vëmendje edhe efektivitetit ekonomik të mundësive nxitëse.

### → E orientuar në të ardhmen & e qëndrueshme

Duke pasur në vëmendje nevojat politike të tregut të punës, Austria e Epërme do të zhvillojë një politikë të përshtatur dhe të diferencuar emigracioni dhe integrimi për të ardhmen. Ardhja e personave me kualifikime të larta, specialistëve dhe studentëve duhet të nxitet dhe duhen krijuar kushtet që këto persona të qëndrojnë në Austrinë e Epërme. Politika integruese e landit të Austrisë së Epërme është një politikë afatgjatë. Objektivi i mundësimin të pavarësisë dhe aftësimin të vetë-mbajtjes nuk mund

të arrihet me anën e masave nxitëse afatshkurtër. Integrimi ka nevojë për shumë durim. Nuk vlen gjithmonë të zgjedhësh rrugën më të thjeshtë apo më të shkurtër por atë më të qëndrueshme. Kjo do të thotë, të zgjedhësh rrugën që të çon në bërjen e një jete vetë-mbajtëse dhe përfshirjen në jetën shoqërore në Austrinë e Epërme.

### → Me orientim të kryqëzuar & lidhës

Integrimi është një materie e kryqëzuar dhe përfshin në shkallë të ndryshme pothuajse të gjithë sektorët shoqëror. Sidomos sektorët e arsimit dhe trajnimit, ekonomia, tregu i punës, shëndeti, ai social, banimi, siguria dhe kultura prekin disa herë çështjet politiko integruese. Masat politiko integruese vendosen si në nivelin e komunave dhe qyteteve ashtu edhe në nivelin e landeve. Në të njëjtën kohë duhet pasur në vëmendje që përveç aktoreve dhe aktorëve shtetëror, në mënyrë shumë të larmishme dhe tepër efektive japin ndihmën e tyre për punën integruese edhe mbështetësit dhe shoqatat jo shtetërore, grupet vullnetare dhe individët. Ky numër i madh i aktoreve dhe aktorëve shtetëror dhe jo shtetëror si dhe i institucioneve bën të domosdoshëm një koordinim dhe lidhje të vazhdueshme. Karakteri i kryqëzuar i integritit në shumë pikëpamjen vë theksin te rëndësia e koordinimit dhe lidhjes me të gjitha qendrat që merren me integrimin të landit të Austrisë së Epërme dhe në landin e Austrisë së Epërme. Prandaj vlen që edhe më tej ndërfaqet dhe pikat tranzitore të përshtaten sa më mirë me njëra-tjetrën për të minimizuar humbjet për shkak të fërkimeve dhe mundëisht për të mënjeluar strukturat e dyfishta.

## 4. Sektorët qendror të politikës integruese

### Gjuha dhe arsimi si kualifikime kyç

**G**ermanishtja si gjuhë e përbashkët formon një fundament kryesor për bashkëjetesën dhe është një aftësi kyçe për të përfituar nga shanset që ofron jeta në vendin tonë. Gjuha e përbashkët mundëson komunikimin ndërmjet vendasve dhe të ardhurve, por edhe ndërmjet të ardhurve me prejardhje dhe gjuhë të ndryshme. Çdonjëri duhet të jetë i ndërgjegjshëm që vetëm zotërimi i mjaftueshëm i gjuhës gjermane mundëson shanse të barabarta dhe pjesëmarrjen në shoqëri.

Kompetenca e mjaftueshme gjuhësore hap derën për arsimimin dhe trajnimin, për tu futur në tregun e punës dhe për të marrë pjesë në jetën kulturore dhe sociale në qytetet dhe komunat e Austrisë së Epërme. Në të njëjtën kohë, kurset e gjuhës duhet të transmetojnë edhe njohuri mbi Austrinë dhe Austrisë e Epërme si dhe mbi vlerat dhe rregullat themelore të bashkëjetesës.



Prandaj ofrimi i mundësive për mësimin e gjuhës është një gur i rëndësishëm në themelin e një politike të suksesshme integruese. Duhet të jetë e diferencuar, që të jetë e orientuar me saktësi dhe në mënyrë rajonale të nevojat e njerëzve. Deri tani i duhet kushtuar vëmendje nivelit gjuhësor në nivelin e shkrimit dhe leximit por edhe kërkesave të veçanta që mund të sjellë me vete profesioni i mëvonshëm. Një vëmendje e veçantë i duhet kushtuar mundësive mbështetëse të mësimin të gjuhës, të cilat mbështesin sidomos mësimin e gjuhës nga ana e grave. Nga njëra anë formojnë gratë multiplikatorë të rëndësishëm për mësimin e gjuhës, nga ana tjetër mësimi i gjuhës gjermane sidomos për gratë është shpesh një hap i rëndësishëm për të marrë vetë vendimi për jetën e tyre në Austrinë e Epërme.

Theksimi i rëndësisë së gjuhës gjermane nuk është kundërshtim me ruajtjen e shumë-gjuhësisë. Zotërimi i shumë gjuhëve përveç gjuhës gjermane vlerësohet dhe nxitet. Në një lokacion biznesi si në Austrinë e Epërme, që ruan dhe jeton shumë kontakte ndërkombëtare, shumë-gjuhësia paraqet një cilësi kualifikuese që nuk karakterizon vetëm personalitetin e dikujt por që paraqet edhe një interes ekonomik. Prandaj një politikë integruese e orientuar te e ardhmja e kupton shumë-gjuhësinë si një shans.

Në shoqërinë tonë arsimit dhe trajnimi janë kushte të rëndësishme për të gjetur një vend në tregun e punës dhe për të krijuar një bazë ekonomike për një jetesë vetë-përcaktuese. Ngritja sociale dhe shoqërore realizohet në mënyrë primare nëpërmjet arsimit. Një detyrë e rëndësishme e politikës integruese është prandaj transmetimi i rëndësisë së arsimit për ngjitjen shoqërore, zgjimi dhe rritja e ambicieve për arsimin dhe garantimi i aksesit të institucionet arsimore.

Një politikë integruese aktivizuese, detyruese duhet të marrë në fokus sidomos fëmijët e emigrantëve dhe emigrantëve. Ato posedojnë me arsimin përkatës dhe nëse është e nevojshme edhe me mbështetje shanset më të mira që familjarizohen në Austrinë e Epërme dhe të organizojnë jetesën e tyre. Për të garantuar një karrierë arsimore, duke pasur në vëmendje sidomos kompetencën gjuhësore duhen marrë parasysh ndërfaqet ndërmjet institucioneve të ndryshme arsimore (kopsht, arsimi parashkollor, shkolla e mesme). Puna e prindërve duhet intensifikuar.

## **Ekonomia dhe tregu i punës — Forcimi i pjesëmarrjes**

Çdonjëra dhe çdonjëri duhet të kujdeset vetë për jetën e saj ose të tij. Sistemi jonë social solidarizues është një rrjetë kapje për ato, të cilët për arsye të ndryshme nuk arrijnë dot të mbajnë vetën e tyre. Shteti social funksionon vetëm atëherë nëse të gjithë në kuadrin e mundësive të tyre kujdesen për pavarësinë e tyre financiare dhe japin kontributin e tyre në sistemin solidarizues. Kjo do të thotë për shembull për emigrantët, që nëpërmjet mësimin të gjuhës gjermane,

arsimit dhe kualifikimit, kërkimit të punës dhe punës të kujdesen për pavarësinë e tyre ekonomike. Kush nuk përpiqet vetë dëmton veten e vet dhe gropos edhe shoqërinë solidarizuese, te e cila bazohet shteti social.

Pjesëmarrja e emigranteve dhe emigrantëve në tregun e punës i shërben çdonjërës dhe çdonjërit, por edhe shoqërisë. Ajo formon bazën për një jetë vetë-përcaktuese, duke krijuar kushtet ekonomike për një gjë të tillë. Për më tepër puna i shërben në mënyrë të drejtpërdrejtë integrimit: Vendi i punës ofron mundësinë e kontakteve të shumta sociale, me anën e të cilave hapen përsëri rrugë të tjera të integrimit shoqëror. Për më tepër pjesëmarrja e emigranteve dhe emigrantëve është një kontribut në fuqinë ekonomike në Austrinë e Epërme.

Një politikë integruese aktivizuese dhe detyruese është në këtë mënyrë një gur i rëndësishëm në politikën ekonomike të landit të Austrisë së Epërme, që dëshiron të forcojë më shumë pozicionin e Austrisë së Epërme si lokacioni kryesor i biznesit në Austri. Në këtë sens politika ekonomike dhe politika integruese duhen menduar tani edhe më tepër si diçka e përbashkët. Ekonomia e Austrisë së Epërme ka nevojë për specialistë. Njerëzit që kanë ardhur të cilët janë të gatshëm të mësojnë gjermanisht, të kualifikohen dhe të angazhohen, janë një shans i madh për lokacionin e biznesit Austria e Epërme. Në të njëjtën kohë duhet përcaktuar që shumë emigrante dhe emigrantë, të cilët kanë ardhur vitet e fundit në Austrinë e Epërme, nuk kanë sjellë me vete aftësitë dhe kualifikimet e domosdoshme për tregun e punës, por duhet ti mësojnë ato në Austrinë e Epërme. Këtu duhen marrë masa të drejtpërdrejta nxitëse të diferencuara në bazë të statusit të qëndrimit, për të menaxhuar sfidën që sa më shumë njerëz të përgatiten për tregun e punës me anën e arsimit dhe trajnimit. Një bashkëveprim efektiv i institucioneve publike dhe ekonomisë private është i domosdoshëm. Emigrantë në moshë të re duhen këshilluar dhe motivuar në lidhje me zhvillimin e tregut të punës në vitet në vazhdim, që të kryejnë trajnime në profesionet e kërkuara. Gratë duhen kontaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë për ti fituar ato për kualifikime dhe trajnime për tregun e punës. Emigrantët të cilët sjellim me vete kualifikime të cilat kërkohen nga ekonomia, duhet të mësojnë me shpejtësi gjermanisht në kursen përkatëse profesionale dhe nëse është e nevojshme të ri-trajnohen në mënyrë që të shfrytëzojnë shpejt dhe në mënyrë jo të komplikuar shanset e tregut të punës. Emigrantët me kualifikime të larta duhen mbështetur me sa mundësi ekzistojnë për njohjen dhe njehsimin e diplomave.

Në vitet e fundit ka dalë në pah që sukcesi i arsimit i vajzave me prejardhje nga emigracioni në krahasim me djemtë me prejardhje nga emigracioni është përmirësuar shumë. Por ky sukses i arsimit nuk pasqyrohet siç dëshirohet në sukseset përkatëse në trajnim dhe në punë. Herë pas herë shembujt tradicionalë paraqesin një pengesë për vajzat. Pengesa të tilla duhen kaluar me anën e një pune të mirë me vajzat, gratë dhe prindërit si pjesë e politikës integruese. Paralel

më këtë një vëmendje e veçantë i duhet kushtuar burrave, të cilën kanë arritur të vetëm në Austrinë e Epërme dhe jetojnë pa pasur lidhje me familjen. Për këtë grup emigrantësh do të jenë të nevojshme edhe më tej masa të përgjithshme dhe specifike integruese.

## **Integrimi dhe bashkëjetesa në vend**

Integrimi është një detyrë e gjithë shtetit, e cila duhet perceptuar nga federata dhe landet në përputhje me kushtetutën. Integrimi zhvillohet në jetën e përditshme të njerëzve atje ku ato janë. Prandaj Austria e Epërme ndjek si një land federal me qytetet, qarqet dhe komunat e saj një strategji integrimi që përfshin të gjitha institucionet, që është e ndarë në rajone dhe është decentralizuar. Një rëndësi të madhe merr prandaj mbështetja e punës integruese nga komuna dhe qarqe të angazhuara.

Emigracioni mund të shkaktojë që në qytete, qarqe dhe komuna njerëz nga grupe të caktuara sociale ose nga vende me një prejardhje të caktuar të jetojnë më shumë së bashku në pjesë të qytetit, lagje ose rrugë. Për sa kohë një gjë e tillë shfaqet me përmasa të ulëta dhe ekzistojnë shumë mundësi për tu përballur me njëri-tjetrin dhe për të ndërtuar ura, një zhvillimi i tillë nuk është problematik. Një bashkëjetesë e mirë ka nevojë për një bashkëpunim të çiltër dhe të relaksuar. Bashkëjetesa si fqinjë duhet të karakterizohet nga respekti reciprok. Por nëse këtë vende tregojnë një pabarazi të madhe sociale, një gjë e tillë mund të çojë në ndarje, dezintegrimit dhe në mjedise paralele problematike, të cilat ndikojnë në mënyrë negative të gjithë. Prandaj duhet që pjesë të mbyllura të shoqërisë, në të cilat njerëzit e jetojnë jetën e tyre të përditshme pa lidhje me një shoqëri të gjerë duke refuzuar rregullat e këtushme, të pengohen. Që me planifikimin e qytetit dhe të komunave, por edhe gjatë dhënies së banesave i duhet kushtuar vëmendje faktit që përzierje të forcohet në aspektin social dhe bazuar në prejardhje. Pasi me kalimin e kohës ne nuk na lidh vetëm prejardhja jonë por edhe interesat dhe pasionet tona.

## **Vlerat dhe traditat të cilat ja vlen të transmetohen**

Bashkëjetesa karakterizohet shumë nga rregulla të pashkruara. Vlerat, traditat, zakonet dhe praktikët e transmetuara nga kultura karakterizojnë jetën e përditshme dhe paraqesin për çdo shoqëri një vlerë. Por tradita të tilla kulturore edhe në Austrinë e Epërme nuk janë të standardizuara por janë tepër të ndryshme; ato janë dinamike dhe i nënshtrohen një transformimi të vazhdueshëm. Me gjithë të gjitha ndryshimeve mbeten zakone të kultivuara, të provuara dhe të transmetuara, të cilat ja vlen që të ruhen. Ato formojnë themelin e bashkëjetesës, në mënyrë që çdo njëra dhe çdonjëri duhet ti njohë ato si pjesë përbërëse e jetës në Austrinë e Epërme.

Këtu përfshihet për shembull që Austria është një vend sekular por në të njëjtën kohë edhe me një qëndrim pozitiv kundrejt fesë. Austria është një vend i hapur, që influencohet nga krishtërimi, që është zotuar për humanizmin dhe iluminizmin. Mospajtimi zgjidhet duke u orientuar te arsyetimi dhe justifikueshmëria racionale e pozicioneve dhe vendimeve. Austria është një vend me një konsensus dhe orientim të theksuar drejt paqes. Kjo do të thotë që çdo formë e dhunës refuzohet. Por kjo do të thotë gjithashtu që edhe aftësia për të vlerësuar veten dhe normat dhe vlerat vetjake, për trajtimin e kritikës dhe përballimin e kritikës, është e kultivuar. Si një land ku arsimit dhe zhvillimi ekonomik shkruhen me shkronja të mëdha, Austria e Epërme bazohet në gatishmërinë e të gjithë njerëzve që jetojnë këtu që të arsimohen dhe trajnohen dhe sipas aftësive vetjake të japin performancën e tyre për ecurinë personale dhe për zhvillimin e landit. Virtytet si përpikmëria në orar, organizimi, besueshmëria dhe mirësjellja e çiltër duhet të qëndrojnë për landin tonë dhe nxisin një të ardhme të përbashkët pozitive. Austria e Epërme ruan festat tradicionale në vjetore si një trashëgimni të përbashkët kulturore. Me dijen që këto vlera, tradita dhe rregulla të shkruara dhe të pashkruara të bashkëjetesës paraqesin pjesërisht një realitet të jetuar dhe pjesërisht një gjendje të dëshiruar ideale, ato krijojnë një ndjenjë të atdheut, besueshmërisë dhe të qenit së bashku dhe i shërbejnë në këtë mënyrë orientimit dhe kohezionit shoqëror.

Trashëgimia kulturore në Austrinë e Epërme ia vlen që të transmetohet më tej. Por e domosdoshme është gjithmonë edhe një konfrontim me praktikën sociale dhe kulturore dhe zakonet dhe me pyetjen, se cilat nga ato duhet të ruhen dhe të zhvillohen më tej dhe cilat jo. Nga marrëdhënia e tensionuar ndërmjet të qëndrueshmes dhe dinamikës, individuale dhe të përbashkëtës, të qenit i hapur kundrejt ndryshimeve dhe të rrënjësorës, ky vend fiton forcën e tij për formimin e të ardhmes.

Asnjëri nuk duhet të heqë dorë ose të mohojë prejardhjen e tij, rrënjët e tij kulturore pse bindjet e tij fetare në Austrinë e Epërme. Megjithatë për emigrantët është e rëndësishme që të njohin praktikën sociale dhe kulturore në Austrinë e Epërme dhe të përballen me to me respekt, për të pasur një shans që të kontaktojnë me të gjithë njerëzit në të njëjtin nivel.

## **Respekt në sjelljen me njëri-tjetrin**

Njohja reciproke dhe respekti reciprok janë kushtet themelore për një bashkëjetesë paqësore si edhe për një kulturë konstruktive diskutimi dhe marrëveshje. Konfliktet duhen zhvilluar të hapura dhe të ndershme nëpërmjet shkëmbimit të argumenteve. Respekt reciprok do të thotë që çdonjëra dhe çdonjëri të përballen me tjetrin me respekt dhe të shfaqë respekt për të. Në të njëjtën kohë duhet të presim nga tjetri që ai të sillet në atë mënyrë që ta fitojë respektin. Anasjelltas, respektin mund ta kërkonti vetëm nëse e jetoni atë: Vetëm

kush sillet me respekt kundrejt të tjerëve, lejohet të presë dhe të kërkojë respekt për veten e vet. Në këtë sens, respekti reciprok ka si kusht paraprak njohjen e barazvlefshmërisë dhe barazisë së atij që keni përballë dhe qëndron në varësi të ngushtë me tolerancën.

Kërkesa për respekt reciprok nuk duhet të jetë një formulë zbutje, për të trajtuar fushat e mundshme të konflikteve ose problemeve ose për të mos u adresuar. Respekti themelor është më tepër një kusht për një diskutim konstruktiv, me të cilin rritet aftësia kritikuese dhe debatuese. Respekti vlen për të gjithë, edhe kundrejt nëpunësve publik si mësues, organe policore etj., pavarësisht nga gjinia e tyre. Zhvlerësimet me bazë kulturore dhe fetare të gjinive ose i njerëzve që nuk besojnë ose kanë një besim tjetër nuk lejohen të kenë hapësirë në bashkëjetesë. Në këtë rast është e rëndësishme që të kuptojmë që zhvlerësimet mund të shfaqen si në shoqërinë pritëse ashtu edhe në grupet e emigrantëve. Pa marrë parasysh se nga cilët shfaqen, ato duhen kundërshtuar me të njëjtën vendosmëri.

Në jetën e përditshme bashkëjetesa e mirë ka si kusht respektin reciprok dhe empatinë. Përsëritja reciproke, pranimiti i nevojës për qetësi të tjetrit dhe marrja parasysh e nevojës për shoqëri të tjetrit, respekti për natyrën, trajtimi me kujdes i pasurisë së përbashkët dhe hapësirës publike janë aspektet e gatishmërisë për të kuptuar njëri-tjetrin, gjë që është kushti i domosdoshëm për një bashkëjetesë të mirë. Kjo është ajo që ky land mbështet.

